



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 302/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z.Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga znj. Samire Osmani B.I - Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE-ve: "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi ne Objektet e KRU Prishtina Sh.A" me nr. prokurimit: 70433736-19-1166-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KRU Prishtina Sh.A, më datën 26.06.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e znj. Samire Osmani B.I -Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi ne Objektet e KRU Prishtina Sh.A" me nr. prokurimit: 70433736-19-1166-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KRU Prishtina Sh.A,.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues KRU Prishtina Sh.A, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi ne Objektet e KRU Prishtina Sh.A" me nr. prokurimit: 70433736-19-1166-2-2-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues znj. Samire Osmani B.I –Suharekë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e Njoftimi për kontratë është bërë me dt:25.03.2019.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt: 17.04.2018.

Data e vendimit për dhënie të kontratës është bërë me dt: 29.05.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt:03.06.2019.

Autoriteti Kontraktues, me datën 05.06.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Znj.Samire Osmani B.I –Suharekë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me11.06.2019me nr. 302/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi ne Objektet e KRU Prishtina Sh.A” me nr. prokurimit: 70433736-19-1166-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- KRU Prishtina Sh.A,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin65 paragrafi 2, neni 66 pika 2 dhe neni 68, 71,72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.06.2019ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt:17.06.2019, sqaron në lidhje me pretendimin ankimor

të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 65 dhe 71 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur “ vetëm njëletër (1 faqe) ku OE Autorizohet nga anëtari Konzerciumit mirëpo nuk ceket asnjë marrëveshje se si do ti përfundojnë punimet dhe nuk posedojnë Deklaratë për secilin nga anëtarët e Konzerciumit”, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Deklaratat nën betim për të dy anëtarët e grupit dhe ka ofruar Deklaratën mbi themelim të grupit të nënshkruar të vulosur nga të dy anëtarët e grupit me të gjitha të dhënat e kërkuara dhe sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar marrëveshje shtesë për kryerje të punimeve.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 66 dhe 72 të LPP se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk posedon licencë për importim të produkteve biocide dhe se nuk e ka licencën për qarkullim me shumicë të produkteve medicinave dhe / apo veterinare, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme në dosje të tenderit është kërkuar që “Operatori Ekonomik duhet të posedojë Leje për import të produkteve biocide të notifikuara lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose të këtë licence për qarkullim me shumicë të produkteve medicinave dhe/apo veterinare”, pra është kërkuar që OE të kenë vetëm njërin nga këto dy dokumente.

Ekspertisqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në ofertë ka ofruar “Aplikacionin për dhënie të produkteve biocide” të protokoluara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 10.04.2019 me Nr. Prot. “2015/19” dhe dokumentin prej tre faqesh të nënshkruar dhe vulosur me titull “Leje për import të produkteve biocide të notifikuara” të datës 09.09.2014 me numër të referencës “14/4193/1-340-DMMU” të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sqaron se ky dokument ka vullën e protokollit me datë 16.09.2014 me Nr. Prot. “4193-2/14”. Ekspertisqaron se në këtë dokument është dhënë leja për Substancë aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo – Dezpelet, Sasia / forma: 8 ton, Nr. i notifikimit: 0268/4193/14/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticid ku në të thuhet se “Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj” dhe se “Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes”.

Po ashtu, në lidhje me këtë, Ekspertisqaron se me datë 07.05.2019 AK ka kërkuar sqarim nga OE i është përgjigjur AK duke dërguar dokumentin prej tre faqesh të nënshkruar dhe vulosur me titull “Leje për import të produkteve biocide të notifikuara” të datës 15.04.2019 me numër të referencës “19/2015/1-293-DMMU” të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sqaron se ky dokument ka vullën e protokollit me datë 19.04.2019, me

Nr. Prot. "2016-2/19". Ekspertisqaron se në këtë dokument është dhënë lejapër Substancë aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo - Dezeplet, Sasia / forma: 5 ton, Nr. i notifikimit 1496/2015/19/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticid dhe se në dosjet e tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk kërkua saktësisht emri i produktit biocid dhe në këtë dokument thuhet se "Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj" dhe se "Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes".

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 68 dhe 72 të LPP-së, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme, Eksperti fillimisht sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek Kapaciteti teknik dhe profesional ka kërkuar "Operatori Ekonomik Tenderuesi me rastin e dorëzimit të tenderit duhet të dëshmojnë se ka kryer se paku dy shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit, duke filluar numërimi prapa nga data e njoftimit për kontratë" dhe si dëshmi "a.(i) nëse shërbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben një Letër Reference të lëshuar nga ana e AK OSE flet dërgese flet pranim ose dokumentit për pranim teknik të pajisjeve, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga ana e AK. ; a.(ii) nëse shërbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti që evidenton një ekzekutim të tillë".

Po ashtu, Eksperti sqaron se kjo pikë është e paqëndrueshme pasi që OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar Listën e kontratave për tre vitet e fundit me gjithsej katër kontrata të përfunduara në vitet 2017, 2018 e 2019 dhe ka ofruar këto dëshmi: 1. "Kontratë shërbimi" e lidhur me datë 04.01.2018 e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët në mes të "VIVA FRESH SHPK" e "VLERA NSHP" ku lënda e kontratës është "DDD" me afat kohor "01.01.2018 deri 31.12.2018"; 2. "Raport pune" lëshuar nga Komuna e Obiliqit për projektin "Deratizimi i ambulantave, çerdhja e qytetit dhe shf. I. Rugova" me nr. të prokurimit "614 18 070 236" ku thuhet që "shërbimet janë kryer me datë 15.12.2018" dhe e cila është nënshkruar nga OE dhe projekt menaxheri; 3. "Faturë nr. 4P/18" e datës 17/12/2018, e nënshkruar për projektin e përmendur në pikën nr. 2; 4. "Letër referencë për DDD" lëshuar nga "VIVA FRESH SHPK" e datës 01.03.2016 ku thuhet që "kontrata është lidhur për afat prej janar 2016, janar 2017 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar"; 5. "Letër referencë për DDD" lëshuar nga "VIVA FRESH SHPK" e datës 01.03.2017, ku thuhet që "kontrata është lidhur për afat prej janar 2017, janar 2018 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar".

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është bërë shkelja e nenit 68 dhe 72 të LPP së, OE i

rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar pajisjet e kërkuara, Eksperti fillimisht sqaron se në dosje të tenderit Aneksi 7 është dhënë një listë nga ana e AK e cila duhet të plotësohet nga OE ofertues dhe sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar dy Lista të pajisjeve: “Listën e pajisjeve siç është kërkuar sipas Aneksit 7” të nënshkruar dhe vulosur nga anëtari i dytë i grupit me gjithsej 7 pajisje e për të cilat ka ofruar sasi të ndryshme dhe “Listën e pajisjeve të kërkuar sipas dosjes së tenderit” me gjithsej pesë pajisje e për të cilat është dhënë përshkrimi se ku mund të gjenden në dokumentacion ku për secilin artikull ka ofruar faturat përkatëse për anëtarin e grupit EKO DEZ DOO në gjuhën serbe, në to ka të shkruar më laps kimik shkrim në to mirëpo mund të shihet saktë përshkrimi i produktit të blerë. Po ashtu, OE ka ofruar edhe dokumente tjera si polisa të sigurimit, certifikata regjistrimesh për automjete, deklaratë për kapacitet teknik të nënshkruar dhe vulosur ku shihet se posedon spërkatës dhe magazinë për ruajtje të prepareve për kontroll të mushkonjave në gjuhën serbe të paguara, andaj kjo pikë është e paqëndrueshme.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet e sipër përmendur nr. 1 deri nr. 4) dhe të mbetet në fuqi Vendimi i AK për dhënie të kontratës.

Znj.Samire Osmani B.I -Suharekë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 19.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues KRU Prishtina Sh.A, përmes parashtresës me shkrim të datës: 17.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtuesi OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Vata deklaroj: Mbetemi në tërësi prapa ankese sonë, kemi pranuar ekspertizën e ekspertës, kundërshtimin do ta bëj në pika të shkurta pak plotësues nga ankesa, Pika e 1-are OE fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm pasi nuk ka paraqitur lejen e Importeve të produkteve BIOCIDET të lëshuar nga ministria e Ambientit këtë nuk e mohon as ekspertja edhe pse në

kushtet e kërkuara kërkohet leja ose licence për qarkullime shumice të produkteve medicinale, pas kërkesës në qasje në dokumente nuk na është bashkangjitur as leja e as licenca dhe konsiderojmë që edhe nëse është i vetmi fakt që konsiderojmë të pa përgjegjshëm këtë OE dhe Autoriteti Kontraktues është dashur të e konsideron të papërgjegjshëm, OE Fitues e ka paraqitur lejen pas mbylljes së afatit dhe data lejes përmban datën 19.04.2019, ndërsa me 14.04.2019 është mbyllur dhe asnjë OE nuk ka të drejtë të plotësojë dokumente shtese, ndërsa tek pika e 2-te OE ka paraqitur fatura të mjeteve të punës me nr: 81223/2019 76027/2009 dhe 51736/2007 faturat të cilat nuk janë të vulosura por vetëm të nënshkruara dhe Autoriteti Kontraktues nuk është dashtë të merr si dokumente të besueshme pa i verifikuar ato, i keni të bashkangjitura në dosje, gjithashtu pika e 3-te Në kërkesën tonë për qasje në DT nuk kemi pranuar dëshmi se OE konform kushteve të kërkuara ta ketë një mjek Veterinar, teknik veterinar të 2 të certifikuar për shërbimet e kërkuara.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Gashi deklaroj: Fillimisht pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertës në përgjigjet e dhëna në pretendimet ankimore të OE Samira Osmani mendoj në mënyrë profesionale E.SH. i ka dhënë të gjitha shpjegimet dhe duke i hedh poshtë të gjitha pretendimet dhe kjo e vërteton se në si Autoriteti Kontraktues kemi vepruar drejt. Pretendimet e OE ankues nuk qëndrojnë asnjë, deri sa në ju kemi kërkuar sqarime dhe na i përcaktoni cilat mjete ku gjenden në dërgon veç aneksin 7 që e ka vulos vetëm dhe nuk përcakton cili mjet është për pozë e renditur. Prapë se prapë në gjatë shqyrtimit e kemi konsideruar si të përgjegjshëm mirëpo kriteri për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm çmimi me i ulët, dhe OE i shpallur fitues e ka plotësuar këtë kriter dhe është propozuar për kontratë.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja profesionale e prokurimit znj. Prebreza deklaroj: Për pos atyre që kam thënë në ekspertizë dua të shtoj se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime për lejen për import të produkteve biocide dhe OE i rekomanduar ka ofruar dokumentin me datë 15.04.2019 mirëpo data e protokollit ka qenë 19.04.2019 në këtë leje shkruan se ky vendim hynte fuqi në datën e nxjerrjes ndërsa hapja e projektit ka qenë me datë 17.04.2019, ndërsa sa i përket se OE ankues se ka kërkuar mjek veterinar kjo nuk ka qenë pjesë e ankesës. Qëndroj prapa raportit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Vata deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Gashi deklaroj:Kërkojmë që ankesa e OE të refuzohet dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertës profesionale të prokurimit , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues znj.Samire Osmani B.I -Suharekë, pretendon se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 65 dhe 71 të LPP-së, dhe e njëjta pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, ka paraqitur "vetëm një letër (1 faqe) ku Autorizohet nga anëtari i Konzerciumit mirëpo nuk ceket asnjë marrëveshje se si do të përfundojnë punimet dhe nuk posedojnë Deklaratë për secilin nga anëtarët e Konzerciumit".

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se është i pabazuar pretendimi i lartpërmendur për faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, ka ofruar Deklaratat nën betim për të dy anëtarët e grupit dhe ka ofruar Deklaratën mbi themelimin të grupit të nënshkruar të vulosur nga të dy anëtarët e grupit me të gjitha të dhënat e kërkuara dhesë në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk është kërkuar marrëveshje shtesë për kryerje të punimeve.

Sa i përket pretendimit të OE ankues znj.Samire Osmani B.I -Suharekë,se është bërë shkelja e nenit 66 dhe 72 të LPP-së, ku OE i rekomanduar përdhënie të kontratës nuk posedon licencë për importim të produkteve biocide dhe se nuk e ka licencën për qarkullim me shumicë të produkteve medicinale dhe / apo veterinare.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se është i pabazuar pretendimi i lartpërmendur për faktin se në dosje të tenderit është kërkuar që "Operatori Ekonomik duhet të posedojë Leje për import të produkteve biocide të notifikuara lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ose të këtë licence për qarkullim me shumicë të produkteve medicinale dhe/apo veterinare", pra është kërkuar që OE të kenë vetëm njërin nga këto dy dokumente, dhe OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, në ofertë ka ofruar "Aplikacionin për dhënie të produkteve biocide" të protokoluara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 10.04.2019 me Nr. Prot. "2015/19" dhe dokumentin prej trefaqësh të nënshkruar dhe vulosur me titull "Leje për import të produkteve biocide të notifikuara" të datës 09.09.2014, me numër të referencës "14/4193/1-340-DMMU" të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe se ky dokument ka vulën e protokollit me datë 16.09.2014 me Nr. Prot.

“4193-2/14”.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se në këtë dokument të cekur si më lartë është dhënë leja për Substancën aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo – Dez pelet, Sasia / forma: 8 ton, Nr. i notifikimit: 0268/4193/14/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticidku në të thuhet se “Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj” dhe se “Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes”.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se në lidhje me këtë dokument autoriteti kontraktues me datë 07.05.2019, ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar dhe i njëjti është përgjigjur autoritetit kontraktues duke dërguar dokumentin prej tre faqesh të nënshkruar dhe vulosur me titull “Leje për import të produkteve biocide të notifikuara” të datës 15.04.2019 me numër të referencës “19/2015/1-293-DMMU” të lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përhershëm nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe sqaron se ky dokument ka vulën e protokollit me datë 19.04.2019, me Nr. Prot. “2016-2/19”. Eksperti sqaron se në këtë dokument është dhënë leja për Substancën aktive: Bromadiolon 0,005%, Produkti: Ratmo - Dezpelet, Sasia / forma: 5 ton, Nr. i notifikimit 1496/2015/19/KOS, Lloji i produktit biocid (PT): Redonticid dhe se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë nuk kërkuar saktësisht emri i produktit biocid dhenë këtë dokument thuhet se “Afati i lejes është për një vit nga data e lëshimit të saj” dhe se “Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes”.

Sa i përket pretendimit të OE ankues znj.Samire Osmani B.I -Suharekë,se bërë shkelja e nenit 68dhe 72 të LPP-së, nga ana e autoriteti kontraktues dhe e njëjta pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar referenca të mjaftueshme.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek Kapaciteti teknik dhe profesional AK ka kërkuar që “Operatori Ekonomik Tenderuesi me rastin e dorëzimit të tenderit duhet të dëshmojnë se ka kryer se paku dy shërbime të ngjashëm në tri vitet e fundit, duke filluar numërimi prapa nga data e njoftimit për kontratë” dhe si dëshmi “a.(i) nëse shërbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij liferimit ekzekutimi shërben një Letër Reference të lëshuar nga ana e AK ose flet dërgese flet pranim ose dokumentit për pranim teknik të pajisjeve, e cila duhet të jetë e nënshkruar nga ana e AK. ; a.(ii) nëse shërbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij liferimit ekzekutimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti që evidenton një ekzekutim të tillë”.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se është i pabazuar pretendimi i

lartpërmendur për faktin se OE i rekomanduar për kontratë "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, në ofertën e tij ka ofruar Listën e kontratave për tre vitet e fundit me gjithsej katër kontrata të përfunduara në vitet 2017, 2018 dhe 2019, dhe i njëjti ka ofruar këto dëshmi si në vijim: 1. "Kontratë shërbimi" e lidhur me datë 04.01.2018 e nënshkruar dhe e vulosur nga të dy palët në mes të "VIVA FRESH SHPK" e "VLERA NSHP" ku lënda e kontratës është "DDD" me afat kohor "01.01.2018 deri 31.12.2018"; 2. "Raport pune" lëshuar nga Komuna e Obiliqit për projektin "Deratizimi i ambulanteve, çerdhja e qytetit dhe shf. I. Rugova" me nr. të prokurimit "614 18 070 236" ku thuhet që "shërbimet janë kryer me datë 15.12.2018" dhe e cila është nënshkruar nga OE dhe projekt menaxheri; 3. "Faturë nr. 4P/18" e datës 17/12/2018, e nënshkruar për projektin e përmendur në pikën nr. 2; 4. "Letër referencë për DDD" lëshuar nga "VIVA FRESH SHPK" e datës 01.03.2016 ku thuhet që "kontrata është lidhur për afat prej janar 2016, janar 2017 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar" ; 5. "Letër referencë për DDD" lëshuar nga "VIVA FRESH SHPK" e datës 01.03.2017, ku thuhet që "kontrata është lidhur për afat prej janar 2017, janar 2018 me kohëzgjatje 1 vjeçare, ne jemi shumë të kënaqur me shërbimet e pranuar".

Sa i përket pretendimit të OE ankues znj.Samire Osmani B.I -Suharekë, se bërë shkelja e nenit 68 dhe 72 të LPP-së, nga ana e autoriteti kontraktues dhe e njëjta pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar pajisjet e kërkuara.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit konstaton se është i pabazuar pretendimi i lartpërmendur për faktin se në dosje të tenderit tek Aneksi 7 është dhënë një listë nga ana e AK e cila duhet të plotësohet nga OE ofertues ku OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "Vlera sh.p.k ,& Eko Dez Doo"-Beograd, ka ofruar dy Lista të pajisjeve: "Listën e pajisjeve siç është kërkuar sipas Aneksit 7" të nënshkruar dhe vulosur nga anëtar i dytë i grupit me gjithsej 7 pajisje e për të cilat ka ofruar sasi të ndryshme dhe "Listën e pajisjeve të kërkuar sipas dosjes së tenderit" me gjithsej pesë pajisje e për të cilat është dhënë përshkrimi se ku mund të gjenden në dokumentacion ku për secilin artikull ka ofruar faturat përkatëse për anëtarin e grupit EKO DEZ DOO në gjuhën serbe, në to ka të shkruar më laps kimik shkrim në to mirëpo mund të shihet saktë përshkrimi i produktit të blerë.

Paneli shqyrtues konform ekspertës profesionale të prokurimit sqaron se OE në fjalë ka ofruar edhe dokumente tjera si polisa të sigurimit, certifikata regjistrimesh për automjete, deklaratë për kapacitet teknik të nënshkruar dhe vulosur ku shihet se posedon spërkatës dhe magazinë për ruajtje të preparateve për kontroll të mushkonjave në gjuhën serbe të paguara

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e ekspertës profesionale të prokurimit vlerëson se autoriteti kontraktues KRU Prishtina Sh.A, ka respektuar procedurat në harmoni me nenet 59 dhe 60 të LPP-së, duke rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik të cilët i kanë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –KRU Prishtina Sh.A
- 1x1 OE- znj.Samire Osmani B.I -Suharekë ,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

